

VENDIM
Nr. 274, datë 12.5.2021

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE QË DUHET TË PËRMBUSHË
ORGANIZATA KOMBËTARE PËRFAQËSUESE RINORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 75/2019, “Për rininë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore (në vijim OKPR-ja) të themelohet nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, dhe të përfaqësojë nevojat dhe interesat e të rinjve pranë grupeve të interesit, duke nxitur gjithëpërfshirjen e të rinjve në procesin e vendimmarrjes.

2. OKPR-ja, që njihet si e tillë nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, duhet të përmbushë këto kritere:

a) të jetë e themeluar dhe e regjistruar në gjykatën kompetente në formën e një shoqate me anëtarësi nga organizata rinore dhe/ose për të rinjtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;

b) të ketë statut të miratuar nga gjykata kompetente;

c) të ketë një anëtarësi prej jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) organizatash rinore dhe/ose për të rinjtë, të cilat duhet:

i. të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;

ii. të kenë shlyer detyrimet tatimore në përputhje me legjislacionin në fuqi;

iii. të kenë përvojë në aktivitetet dhe veprimtaritë rinore;

iv. të mos jenë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;

v. të mos jenë të dënuar, organizata dhe përfaqësuesi i saj ligjor, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

vi. të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në 12 (dymbëdhjetë) qarqet e Republikës së Shqipërisë, sipas ndarjes territoriale;

vii. të kenë diversitet në fushat e veprimtarisë rinore ose për të rinjtë në të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

3. Të drejtën për të kërkuar njohjen si OKPR e kanë organizatat, të cilat plotësojnë kriteret e këtij vendimi dhe përparësi kanë organizatat, anëtarët themelues të të cilave kanë eksperiencë më të gjatë, numrin më të lartë të anëtarësisë së organizatave rinore, mbulojnë me veprimtari pjesën më të madhe të territorit të Republikës së Shqipërisë, kanë bashkëpunime me organizata me status të ngjashëm që veprojnë në vendet e Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe në rast se 70% e organizatave të anëtarësuara janë organizata rinore.

4. Dokumentacioni, që duhet të depozitohet nga organizata jofitimprurëse pranë Agjencisë Kombëtare të Rinisë për t’u njohur si OKPR, përmban:

a) aktin e regjistrimit në gjykatë;

b) kopjen e statutit të saj;

c) kopje të statuteve të organizatave themeluese të OKPR-së, ku specifikohen si pjesë e veprimtarisë së tyre aktivitete dhe veprimtari rinore;

ç) vërtetimet nga organet tatimore që organizatat themeluese të OKPR-së i kanë përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimet;

d) vërtetimet nga gjykata se organizatat themeluese të OKPR-së nuk janë në procedurë falimenti dhe/ose likuidimi;

dh) vërtetime nga gjykata se organizatat themeluese të OKPR-së dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe